



UNIVERSITY EDUCATORS  
FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT

# Pedagogët Universitarë për Zhvillimin e Qëndrueshëm

**K**onsorciumi UE4SD, i përbërë prej 55 partnerësh nga 33 vende europiane, synon të riorientojë kurrikulën e Arsimit të Lartë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Ky projekt 3-vjeçar do të mbështesë pedagogët për të përgatitur studentët që të kuptojnë dhe të zbatojnë përgjegjësitë e tyre profesionale dhe globale në zhvillimin e qëndrueshëm. Projekti përfshin aktivitete, ku do të përfshihet stafi akademik, që do të synojnë zhvillimin e roleve dhe përgjegjësiive profesionale si dhe aftësiive akademike për leadership në lidhje me Arsimin e Lartë për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

UE4SD synon të krijojë një grup ekspertësh për edukimin e kompetencave për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Arsimin e Lartë në Europë dhe do të krijojë një platformë për të kombinuar dhe shkëmbyer ekspertizën e partnerëve të rrjetit me qëllim ndikimin e politikave dhe praktikës edhe pas përfundimit të projektit. Aktivitetet përgjatë projektit do të jenë ngushtësisht të lidhura me Aleancën Koperniku, Rrjeti European për Arsimin e Lartë për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

## Pse edukim për zhvillimin e qëndrueshëm?

Zhvillimi i qëndrueshëm është evidentuar si një nga sfidat më të mëdha që shoqëritë tona po perballen në shekullin e 21-të. Praktikant jo të qëndrueshme kanë rritur pabarazitë sociale, ekonomike dhe mjedisore, kanë përkeqësuar impaktin e degradimit të mjedisit dhe kanë kufizuar cilësinë e jetës. Është njohur dhe pranuar roli i sistemit të edukimit për përparimin e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm sepse sistemi i edukimit i pajis studentët me njohuri, shprehje dhe qëndrime të nevojshme për të riorientuar strukturat sociale dhe sistemet.

Projekti UE4SD është krijuar për të mbështetur mesimdhënien dhe të mësuarit për qëndrueshmërinë në nivelin e arsimit të lartë. Sektori i Arsimit të Lartë është një pjesë e rëndësishme e sistemit për të adresuar zhvillimin e qëndrueshëm sepse ai është sistemi që përgatit brezat e rinj të profesionistëve, sfidon me paradigma të reja teorike dhe zhvillon kërkimin shkencor në këtë fushë. Megjithatë, ka fakte që tregojnë se riorientimi i kurrikulës së arsimit të lartë në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm ka akoma nevojë për udhëheqje dhe mbështetje nëse universitetet do të duan të kontribuojnë për një të ardhme të qëndrueshme.

## Projekti


UE4SD financohet nga Komisioni European, Programi për Arsimin Gjatë Gjithë Jetës, Rrjetet Akademike Erasmus. Projekti filloi zbatimin në Tetor 2013 dhe do të përfshijë 55 partnerë në 33 vende (shihni hartën) gjatë një kohëzgjatjeje prej 3 vjetësh. Universiteti i Gloucestershire (Mbretëria e Bashkuar), është institucioni që udhëheq projektin së bashku me tre partnerë të tjerë, që janë: Universiteti Autonom i Madridit (Spanjë), Universiteti Charles (Republika Çeke), Universiteti Leuphana i Lünenburg-ut (Gjermani)

## Cilat janë kontributet e projektit?

Projekti do të kontribuojë për të riorientuar arsimin e lartë drejt zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet **tre produkteve kryesore:**



UNIVERSITY EDUCATORS  
FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT



1

### Rishikimi i situatës dhe evidencimi i praktikave udhëheqëse (2014):

Kryerja e një studimi në fushë për të hartëzuar dhe analizuar mundësitë ekzistuese në nivel lokal dhe rajonal për pedagogët e arsimin të lartë për të zhvilluar edukim për aftësitë e zhvillimit të qëndrueshëm. Do të prodhohen 4 raporte rajonale dhe 1 raport i përbashkët për situatën në gjithë vendet pjesëmarrëse në projekt.

2

### Zhvillimi i burimeve (2015-2016):

Praktikat udhëheqëse të identifikuar nga studimi i situatës do të përbëjnë bazën e këtij botimi. Do të krijohet një platforme online me burime të nevojshme për të ndihmuar pedagogët dhe profesionistët e fushës.

3

### Zhvillimi i akademisë për

### edukimin në zhvillimin e qëndrueshëm në Arsimin e Lartë (2015-2016):

Dy produktet e mësipërme do të mbështesin zhvillimin e mendimit dhe praktikës akademike për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm në Arsimin e Lartë, që synon për të mbështetur riorientimin e Arsimin të Lartë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo fazë do të ndihmojë në zhvillimin e kapaciteteve dhe mundësi për të reflektuar për pedagogët universitarë dhe stafet përgjegjëse për zhvillimin profesional.

## Cilat janë dokumentet ku bazohet projektit?

Projekti mbështetet mbi Kornizën për Zhvillimin e Kompetencave për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Edukim të vendeve të ndryshme të rajonit UNECE. Këto kompetenca u zhvilluan përgjatë një procesi 3-vjeçar që përfshiu ekspertë të ndryshëm dhe që është një burim i vlefshëm për aktivitetet e rrjetit UE4SD. Linku në internet për Kornizën e Kompetencave UNECE: <http://www.unece.org>

Programi për Veprimin Global i UNESCO për Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm identifikon ndryshimin tërësor të institucioneve si prioritet për sistemin e edukimit. Ky projekt bazohet në punën e bërë nga UNESCO, që në mënyrë të vecantë thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional të pedagogëve, mësuesve dhe trainerëve për t'u bërë lehtësues të të mësuarit për zhvillimin e qëndrueshëm. Linku në internet për Programin për Veprimin Global të UNESCO: <http://www.unesco.org>



Lifelong  
Learning  
Programme

With the support of the Lifelong Learning Programme of the European Union



## Cilat do të jenë rezultatet e projektit?

- Të krijojë një grup ekspertësh në edukimin për aftësitë në zhvillimin e qëndrueshëm në Arsimin e Lartë në Europë, grup që mund të ndikojë politikatat dhe praktikatat në këtë fushë.
- Të nxisë kuptimin e lidhjes midis edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm, rritjen e cilësisë dhe zhvillimit profesional.
- Të sigurojë udhëheqje, mbështetje dhe burim që rrisin zhvillimin e kapaciteteve të pedagogëve universitarë.

## Nëse jeni të interesuar për projektin UE4SD?

Ju lutemi na kontaktoni ose vizitoni website e projektit:

<http://www.ue4sd.eu>

Email: [ue4sd@glos.ac.uk](mailto:ue4sd@glos.ac.uk)